



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Dhjetor 2023

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Dhjetor 2023

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin dhjetor të vitit 2023)**

Mbahet takimi i Grupit të punës për hartimin e draftit të Rregullores së ZMNV-së

Prishtinë, 1 dhjetor 2023

Pas formimit të Grupit të punës për hartimin e draftit të Rregullores për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV), sot është mbajtur takimin i parë i tij, i kryesuar nga prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Bahri Hyseni, në të cilin morën pjesë prokurorët që kanë trajtuar lëndët e dhunës në familje nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Zyrtarja e Lartë Ligjore në OPDAT në Ambasadën Amerikane, Benina Kusari dhe zyrtarët nga radhët e KPK-së, ZKPSH-së dhe ZMNV-së.



Me këtë rast, anëtarët e këtij grupi diskutuan për draftin e Rregullores për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, duke vënë theksin në rolin dhe rëndësinë e ZMNV-së për ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës së viktimave të krimit, me ç'rast u tha se ky mekanizëm i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ka krijuar përparësi të konsiderueshme për vendin tonë në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të viktimave në krahasim me vendet e tjera të regionit.

Andaj, gjatë diskutimeve të sotme, u tha se gjatë punës nevojitet përditësimi i konsiderueshëm i draftit të kësaj rregulloreje, në mënyrë që të jetë në harmoni me ndryshimet ligjore, zbatimi i të cilit pas miratimit nga komisioni përkatës dhe procedimit të tij për miratim në KPK, do të ndikojë në fuqizimin e mëtejshëm të mbrojtjes dhe ofrimit të ndihmës për viktimat e krimit në Republikën e Kosovës.

Mbahet takimi i Komisionit për Rishqyrtim të kundërshtimeve të kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

Prishtinë, 6 dhjetor 2023

Komisioni për Rishqyrtim të kundërshtimeve të kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), i kryesuar nga anëtarja e Këshillit Prokurorial, znj. Jehona Grantolli, në përbërje të të cilit janë edhe dy anëtarë të tjerë të KPK-së, znj. Arjana Shajkovi dhe z. Armend Zenelaj, ka mbajtur takim për t'i trajtuar kundërshtimet e kandidatëve për Kryeprokuror të PSRK-së.



Në këtë takim të Komisionit për Rishqyrtim morën pjesë në cilësinë e monitoruesve përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane, EULEX-it, EUKOJUST-it dhe Zyrës së BE-së në Prishtinë.

Komisioni për Rishqyrtim, pas trajtimit të sotëm që u bëri kundërshtimeve të kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, do të përgatisë raport për KPK-në, i cili do të trajtohet në takimin e radhës së KPK-së.

KPK-ja ka miratuar më 17 nëntor listën prej katër kandidatësh për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si në vijim: Blerim Isufaj, Valdet Gashi, Atdhe Dema dhe Naim Abazi.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do të njoftojë me kohë për procedurat e tjera të procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit të PSRK-së.

Mbahet tryezë e rumbullakët për trajtimin efikas të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore

Prishtinë, 7 dhjetor 2023

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), në kuadër të fushatës së përvitshme sensibilizuese "16 Ditët e aktivizimit kundër dhunës në familje, dhunës në baza

gjinore dhe dhunës ndaj grave", organizoi një tryezë të rumbullakët, në të cilën morën pjesë prokurorët nga ZKPSH-ja, znj. Sevdije Morina, njëkohësisht, Koordinatore për rastet e dhunës në familje në ZKPSH dhe z. Bahri Hyseni, Prokuror në ZKPSH, Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, znj. Shenaj Berisha, mbrojtësit e viktimave dhe përfaqësuesja e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.



Qëllimi i mbajtjes së kësaj tryeze ishte diskutimi rreth trajtimit të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore, identifikimit të mekanizmeve dhe metodave të përbashkëta dhe rolit të institucionit Prokurorit të Shtetit në luftimin e dhunës ndaj grave, si dhe bashkërendimit dhe koordinimit të mëtejshëm të trajtimit sa më efikas të rasteve të këtyre formave të dhunës.



Gjithashtu, në këtë tryezë, pjesëmarrësit diskutuan edhe për hyrjen në fuqi të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, me ç'rast të pranishmit u informuan për risitë e këtij ligji, duke theksuar se do të ketë angazhim adekuat të mekanizmave të sistemit prokurorial për trajtimin efektiv dhe efikas të këtyre rasteve.

Në përfundim të tryezës, të pranishmit shprehën gatishmëri për të bashkëpunuar dhe koordinuar trajtimin e rasteve të dhunës në familje, në baza gjinore dhe dhunës ndaj grave, si pjesë e përpjekjeve për luftimin e shkeljeve të papranueshme të të drejtave themelore të njeriut.

Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 7 dhjetor 2023

Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë edhe përfaqësuesit e UNDP-së dhe Zyrës së BE-së në Kosovë.



Gjatë takimit të sotëm është punuar drafti fillestar i Rregullores për Themelimin e Zyrës për Rikthimin e Aseteve, zyrë kjo, e cila do të themelohet në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për të ofruar ndihmë dhe këshilla në gjurmimin e pasurisë, bashkëpunimin me institucione financiare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në arritjen e synimeve për kthimin e pasurisë së fituar përmes veprës penale.

Pas përfundimit të draftit fillestar, anëtarët e Komisionit për Çështje Normative morën vendim që ky draft të dalë në dëgjim publik dhe pas marrjes së komenteve dhe shqyrtimit të tyre të finalizohet dhe procedohet për miratim në njërin nga takimet e KPK-së.

Mbahet takimi i Komisionit për Administrim të Prokurorive

Prishtinë, 8 dhjetor 2023

Komisioni për Administrimin e Prokurorive i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga z.Veton Shabani, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij Komisioni, anëtarët e Grupit punues të përdoruesve të SMIL-it, përfaqësuesit e Zyrës së BE-së dhe zyrtarë të njësive administrative të SKPK-së.



Qëllimi i këtij takimi ishte konstituimi i Grupit punues të përdoruesve të SMIL-it, i themeluar nga Këshilli Prokurorial të Kosovës me propozim të Komisionit për Administrimin e Prokurorive.

Gjatë takimit, Komisioni njoftoi Grupin punues me detyrat dhe përgjegjësitë e veta dhe prioritetet e Komisionit sa i përket avancimit të SMIL-it, raporteve statistikore, kualitetit të të dhënave dhe regjistrave elektronikë, që do të jenë fokusi i përgjegjësisë të këtij grupi. Ky grup punues përbëhet prej 7 anëtarësh prokurorë nga të gjitha nivelet e prokurorive të Kosovës, i cili ndër detyrat kryesore të tij ka avancimin e zbatimit të SMIL-it dhe ngritjen e cilësisë së të dhënave.

Anëtarët e Grupit punues diskutuan dhe u pajtuan lidhur me hapat e ardhshëm fillestarë që do të ndërmarrin në zbatim të vendimit të Këshillit.

KPK-ja zgjodhi Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale dhe kryeprokurorët e prokurorive themelore në Prishtinë dhe në Gjakovë

Prishtinë, 11 dhjetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Jetish Maloku, ka zhvilluar takimin e 238-të me radhë dhe, sipas agjendës, me vetëm tre pika të parapara në rendin e ditës.

Gjatë këtij takimi janë zgjedhur kryeprokurorët e tri prokurorive të rëndësishme të vendit, me ç'rast fillimisht anëtarët e KPK-së votuan me shumicë votash dhe zgjodhën z.Blerim Isufaj edhe për një mandat në krye të Prokurorisë Speciale, duke filluar nga 1 janari 2024.



Gjithashtu, në të njëjtin takim, KPK-ja votoi edhe për zgjedhjen e kandidatit të vetëm për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, z.Zejnulla Gashi, prokuror i kësaj prokurorie, i cili u zgjodh me një mandat katërvjeçar, duke filluar nga 1 janari 2024.

Po ashtu, nën pikën tre të këtij takimi, Këshilli votoi edhe për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, z.Enis Gashi, prokuror i kësaj prokurorie, i cili do të udhëheqë këtë prokurori gjatë katër vjetëve të ardhshëm, duke filluar nga 1 janari 2024.

Zgjedhjeve të kryeprokurorëve u kanë paraprirë trajtimi i Raportit të Komisionit për Rishqyrtim dhe dy raporteve të paneleve vlerësuese.

Mbahet takimi i parë i Grupit të punës së përdoruesve të SMIL-it në sistemin prokurorial

Prishtinë, 12 dhjetor 2023

Grupi i punës së përdoruesve të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) në sistemin prokurorial, i udhëhequr nga kryesuesja e këtij grupi, prokurorja në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj.Sevdije Morina, ka mbajtur takimin e parë, në të cilin morën pjesë anëtarët dhe zyrtarët përkatës të njësisë organizative të SKPK-së dhe NJSHPP-së.



Qëllimi i takimit të sotëm ishte diskutimi për prioritetet e punës, të cilat ndikojnë në zbatimin efikas dhe efektiv të digjitalizimit të plotë të punës dhe

angazhimin për largimin e formës së punës manuale të raporteve dhe regjistrave që gjenerohen në SMIL.

Më këtë rast është diskutuar për pyetësorët e SMIL-it që nevojiten për të marrë përshtypjet e përdoruesve në aspektin e përdorimit të SMIL-it dhe avancimin e tij, pyetësorë këta, të cilët janë aprovuar nga grupi punues.

Ndër të tjera, në takimin e sotëm janë shqyrtuar edhe raportet e ndryshme, si dhe ato që ndërlidhen me mekanizmin përcjellës, vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe të ngjashme.

Në përfundim të këtij takimi, grupi punues caktoi prioritetet e zhvillimit të raporteve në SMIL, përfshirë edhe afatet kohore për realizimin e tyre.

Kryesuesi Maloku priti në një takim lamtumirës drejtuesin e projektit EUKOJUST, z.Volkmar Theobald

Prishtinë, 12 dhjetor 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, z.Jetish Maloku, së bashku me Zëvendëskryesuesin e KPK-së, z.Veton Shabani, priti në një takim lamtumirës drejtuesin e projektit EUKOJUST, z. Volkmar Theobald, i cili së shpejti do të përfundojë mandatin e tij në kuadër të këtij projekti.



Me këtë rast, Kryesuesi i KPK-së, z.Maloku, falënderoi drejtuesin e Projektit EUKOJUST, z.Theobald, për vizitën e tij, duke thënë se ky projekt ka pasur ndikim të madh në shumë fusha në kuadër të zbatimit të objektivave strategjike të sistemit prokurorial.

Na ana tjetër, drejtuesi i këtij projekti, z.Theobald, falënderoi Kryesuesin Maloku për pritjen, duke theksuar se do të ketë vazhdimësi të këtij projekti dhe mbështetje të mëtejshme të sistemit prokurorial për forcimin e zbatimit të ligjit në Kosovë.

KPK-ja dhe Projekti EUKOJUST që zbatohet në kuadër të Programit të BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë, bashkëpunojnë për zbatimin e

objektivave specifike që ndërlidhen fuqizimin e llogaridhënie, transparencës, profesionalizmit, cilësisë, efektivitetit, pavarësisë dhe paanësisë së sistemit prokurial të Kosovës.

Kryesuesi Maloku priti në një takim njohës drejtorët e rinj të administratës së sistemit prokurorial

Prishtinë, 15 dhjetor 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z.Jetish Maloku, ka pritur në një takim njohës Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, z.Sami Istrefi dhe Drejtoreshën e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, znj.Arta Kelmendi, me ç'rast u zhvillua edhe ceremonia e pranimit dhe dorëzimit të detyrave të tyre.



Kryesuesi Maloku, duke uruar drejtorët e rinj për zgjedhjen e tyre në krye të administratës së sistemit prokurorial, theksoi se faktikisht zgjedhja e tyre është një mundësi e re për fuqizimin e mëtejshëm dhe arritjen e koherencës në të gjitha proceset e punës.

Pas njoftimit të drejtorëve të rinj për proceset aktuale, si dhe për aktivitetet e parapara dhe veprimtarinë që do të zhvillohen gjer në fundvit, ndër të tjera, është diskutuar edhe për përmbylljen me kohë të planifikimeve që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të KPK-së dhe institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Rjedhimisht, në fund të takimit, drejtorët e rinj u zotuan se do të angazhohen me vullnet dhe përkushtim të madh për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësisë që morën sot dhe, njëkohësisht, për zbatimin e një kornize



të qartë të punëve ekipore, të cilat do të ndikojnë në tejkalimin e sfidave, ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve për të pasur efikasitet dhe efektivitet në punë, llogaridhënie dhe transparencë.

Reagim i KPK-së ndaj shkarkimit të anëtarit joprokuror, profesorit Agron Beka, nga Kuvendi i Kosovës

Prishtinë - 15 dhjetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), njofton se ka përcjellë me shqetësim seancën e sotme të punimeve të Kuvendit të Kosovës.

Me këtë rast, KPK-ja konstaton me shqetësim të thellë se me rastin e shkarkimit të Prof.Asoc.Dr.Agron Bekës nga pozita e anëtarit joprokuror të KPK-së, instanca më e lartë legjislativë, siç është Kuvendi i Kosovës, ka bërë shkelje ligjore, sepse institucioni i vetëm kompetent në bazë të legjislacionit në fuqi, për t'i shqyrtuar shkeljet eventuale të anëtarëve është Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe mekanizmat e tij.



Mbi të gjitha, KPK-ja thekson se vendimi i sotëm i Kuvendit të Kosovës është një tentativë e madhe politike për të ndërhyrë në përbërjen aktuale të anëtarëve të KPK-së, duke krijuar para opinionit publik një pasqyrë të rreme faktesh dhe argumentesh, me synimin e vetëm për të penguar funksionimin normal të këtij organi të pavarur kushtetues dhe

ligjor. Kjo ndërhyrje për KPK-në është cenim i funksionimit të rregullt të saj.

KPK-ja, ka njoftuar opinionin e gjerë se anëtari i KPK-së, Prof.Asoc.Dr.Agron Beka, ka ofruar mjaft prova, duke demantuar plotësisht pretendimet e pabaza që dërguan deri te ky shkarkim joligjor, andaj Këshilli Prokurorial i Kosovës, përmes këtij reagimi publik, bënë me dije përfundimisht se të gjitha insinuatat e partisë politike në pushtet janë shpifje, fyerje dhe keqpërdorim i besimit qytetar.

Kjo vërtetohet me vendimin e sotëm për shkarkimin e z.Beka, pa pasur asnjë argument ligjor, por vetëm me qëllim të denigrimit të figurës së tij dhe me qëllim të realizimit të interesave të tyre politike dhe krejt kjo pas gjashtë tentimeve për ta vënë në rend dite.

KPK-ja, vlerëson se anëtari i KPK-së, z.Agron Beka, gjatë angazhimit të tij në KPK nuk ka pasur asnjë vërejtje në ushtrimin e detyrës së tij dhe asnjë shkelje dhe aq më pak procedurë, por me punën e tij dhe profesionalizmin e treguar ka ndihmuar sistemin prokurorial dhe KPK-në në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë kushtetuese.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, shpreh bindjen se z.Agron Beka ka vepruar në kuadër të autorizimeve të veta si anëtar i KPK-së dhe këtë vlerësim nuk mund ta bëjë askush tjetër përpos organit ku punon dhe vepron. Por tashmë tendenca ka marrë hov dhe shkarkimi i tij është një dëshmi e pamohueshme se po tentohet të merret nën kontroll institucioni më i rëndësishëm kushtetues, i cili është themel për ta ruajtur sigurinë juridike në këtë vend.

KPK njofton opinionin e gjerë se do të përdorë të gjithë mekanizmat e saj kushtetues dhe ligjor për ta kontestuar këtë paligjshmëri që bëri sot pushteti ndaj KPK-së.

Mbahet trajnim për komisionet për vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe gjyqtarëve

Prishtinë, 19 dhjetor 2023

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin Chemonics, ka mbajtur një trajnim dyditor për komisionet për vlerësimin e performancës në Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor, në të cilin me morën pjesë kryesuesit e Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor, Kryetari i Gjykatës Supreme, Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorë dhe kryetarë të gjykatave, gjyqtarë nga Gjykata Supreme, anëtarë të Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor, anëtarë të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së

Prokurorëve dhe Gjyqtarëve, inspektorë të lartë gjyqësorë, zyrtarë të statistikave, anëtarë të komisioneve të përhershme në KPK, si dhe udhëheqës të departamenteve të trajnimeve dhe të IT-së dhe zyrtarë ligjorë.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte vazhdimësia e ofrimit të trajnimeve për prokurorë dhe gjyqtarë, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre profesionale, prej të cilave kanë rezultuar edhe zhvillimet e kurrikulave trajnuese për anëtarët e këtyre komisioneve.



Me këtë rast, Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku dhe pjesëmarrësit e tjerë nga radhët e të dy Këshillave, vlerësuan lart nevojën për trajnime shtesë dhe specializim për anëtarët e komisioneve për vlerësim të performancës, sidomos për vlerësimin e indikatorëve matës për shkak të vështirësive dhe sfidave, të cilat dalin gjatë zbatimit të Rregullores për Vlerësimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.



Ky trajnim është moderuar dhe udhëhequr nga dy ekspertët britanikë, z. Jonathan Carroll dhe z.Allan Cansick, si dhe nga dy kryetarët e komisioneve për vlerësimin e performancës në KPK, z.Ardian Hajdaraj dhe në KGJK, znj.Teuta Ibrahimli.

Gjatë sesioneve dyditore u diskutuan ndryshimet e nevojshme legjislativ të akteve të brendshme, të cilat do t'u mundësonin komisioneve një punë më praktike dhe më të matshme dhe pati diskutime edhe për proceset e vlerësimit dhe ankimit, vëzhgimit dhe monitorimit në praktikë të prokurorëve dhe

gjyqtarëve, paragjykimet e pavetëdijshe, sistemet për mbledhjen e informatave dhe për çështjet e integritetit dhe etikës në sistemin prokurorial dhe gjyqësor.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së priti në një takim ekspertin e projektit EUKOJUST

Prishtinë, 19 dhjetor 2023

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Sami Istrefi, ka pritur në një takim ekspertin e Projektit EUKOJUST, z. Cristian Nicoara.



Qëllimi i takimit të sotëm ishte diskutimi për fazën e tashme të implementimit të projektit EUKOJUST dhe për bashkërendimin e aktiviteteve dhe prioritetëve të përbashkëta në kuadër të fuqizimit të kapaciteteve administrative të sistemit prokurorial.

Me këtë rast, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit, z.Istrefi, falënderoi ekspertin e projektit EUKOJUST, z.Nicoara, duke kërkuar përkrahjen e projektit EUKOJUST për finalizimin e Strategjisë për Komunikim Publik, për të përmirësuar cilësinë e komunikimit të sistemit prokurorial dhe për rritjen e transparencës ndaj opinionit të gjerë publik.

Përfaqësuesi e projektit EUKOJUST, z.Nicoara, theksoi se bashkëpunimi me sistemin prokurorial është shtrirë në shumë fusha në kuadër të zbatimit të objektivave strategjike, duke konfirmuar ofrimin e mbështetjes dhe ekspertizës deri në përmbylljen e këtij projekti.

Bashkëbiseduesit u pajtuan për të punuar sipas planifikimit dhe duke identifikuar çështje dhe sfida, me të cilat ballafaqohet Këshilli dhe Prokurori i Shtetit, në mënyrë që të harmonizohen dhe koordinohen veprimet e ardhshme për adresimin efikas të tyre.

Mbahet Takimi i 239-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 22 dhjetor 2023

Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi z.Jetish Maloku, ka mbajtur Takimin e 239-të me radhë, me ç'rast janë diskutuar dhe miratuar pikat sipas rendit të ditës.



Fillimisht, anëtarët e KPK-së, kanë shprehur shqetësim e tyre për shkarkimin nga Kuvendi i Kosovës të anëtarit joprokuror të KPK-së, z.Agron Beqa, ku KPK-ja ka informuar opinionin publik përmes një komunikate të premtën e kaluar se Kuvendi ka bërë shkelje ligjore, duke theksuar se institucioni i vetëm kompetent në bazë të legjislacionit në fuqi, për t'i shqyrtuar shkeljet eventuale të anëtarëve është Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe mekanizmat e tij.

Në takimin e sotëm, KPK-ja themeloi Panelin Hetimor për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe miratoi Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, (do të hyjë në fuqi më 1 prill 2024) dhe Rregulloren për Qasje në Dokumente Publike të Sistemit Prokurorial.

Gjithashtu, anëtarët e Këshillit miratuan edhe Programin e Punës së Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve për vitin 2024 dhe Dokumentin e Politikave të Trajnimit dhe Planin e Nevojave për Trajnimin e Prokurorëve të Shtetit dhe Stafit Administrativ për vitin 2024, i cili do t'i dërgohet Akademisë së Drejtësisë, si dhe Raportin për periudhën janar-qershor 2023 për zbatimin e Planit të Veprimit të Planit Strategjik të Sistemit Prokurorial 2022-2024.

Rrjedhimisht, në rendin e ngjeshur të ditës së sotme që kishte, KPK-ja aprovoi gjithashtu dy raporte të Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve dhe avancoi z.Arben Hoti dhe znj.Fatmire Cacaj në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe znj.Zana Sadiku-Sertolli dhe znj.Mimoza Shala në

Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Këshilli në vijim mori vendim për hapjen e shpalljes së brendshme për avancimin e një prokurori në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe për avancimin e një prokurori në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, si dhe mori vendim për hapjen e shpalljes së brendshme për plotësimin me nëntë pozita prokurorësh në PSRK, shpallje këto, të cilat do të publikohen më 27 dhjetor 2023, si dhe për lirimin nga detyra të prokurorit Muharrem Bajraktari për shkak të ofrimit të dorëheqjes së tij nga Prokuroria Themelore në Pejë dhe do ta dërgoj propozimin tek Presidentja e vendit për ta liruar nga detyra.

KPK-ja ka shtyrë për takimin e radhës shqyrtimin e Analizës së Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë dhe shpalljen e konkursit për rekrutimin e prokurorëve të rinj të Shtetit, për shkak të mungesës së anëtarit joprokuror të Këshillit-shkarkimit nga Kuvendi i Kosovës me çka nga ky shkarkim ka shkaktuar pengesa të mëdha në sistemin prokurorial të Kosovës.

Në përfundim të takimit, anëtarët e KPK-së trajtuan Raportin për vlerësimin e performancës së 12 prokurorëve me mandat të përhershëm dhe kundërshtimet e paraqitura dhe mbajti një seancë dëgjimore disiplinore për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Urimi i Kryesuesit të KPK-së, z.Jetish Maloku, me rastin e festave të fundvitit

Të nderuar,

Këshilli Prokurorial i Kosovës ju uron festat e fundvitit, duke ju dëshiruar gjithë të mirat për një vit të ri të lumtur dhe të begatë. Gëzuar për shumë mote!



Reagim i KPK-së ndaj deklaratave të Kryeministrit Kurti lidhur me punën e Prokurorisë Speciale për sulmin në Banjskë të Zveçanit

Prishtinë, 23 dhjetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës reagon me indignatë ndaj deklaratave të sotme të Kryeministrit të Kosovës, sipas të cilit, kinse, Prokuroria i Shtetit nuk ka ngritur aktakuzë të shumta për sulmin në Banjskë të Zveçanit.

Me këtë rast, KPK-ja thekson se, Prokuroria Speciale, në përputhje me ligjin, operon si një institucion i pavarur dhe bashkëpunon me të gjitha institucionet e sundimit të ligjit për mbledhjen e fakteve.



Gjithashtu, Këshilli, shprehet qartë edhe njëherë se, kjo prokurori kompetente është gjithmonë në dispozicion për të ndarë informacionin e nevojshëm me publikun dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, duke pasur parasysh gjithnjë parimet e mbrojtjes së informacionit dhe hetimeve aktuale.

Rrjedhimisht, KPK-ja kërkon nga Qeveria e Kosovës që të lejojë të gjitha organet të veprojnë në përputhje me ligjet dhe autorizimet e vlefshme në vend dhe se këto deklarata i quan paraqitje publike të ricikluara të Kryeministrit që kanë përmbajtje

tendencioze ndaj institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe bazohen në veprime jokorrekte, joetike, të padinjitetshme dhe mbi paragjykime dhe hamendësime të shpeshta, të cilat po bëhen në secilin rast që atij dhe anëtarëve të kabinetit të tij iu jepet mundësia.

Përmes këtij reagimi publik, KPK-ja i bënë thirrje Kryeministrit Kurti që të qëndrojë larg institucioneve të sistemit prokurorial dhe të mos ndërhyjë në institucionet e pavarura kushtetuese, siç është Prokurori i Shtetit, për të tentuar të linçojnë publikisht çdo gjë që ka të bëjë me institucionin e Prokurorit të Shtetit dhe punën e prokurorëve dhe prokurorëve të shtetit, ngaqë si të tilla përbëjnë shkelje të patolerueshme në punën e pavarur të institucioneve prokuroriale.

Prandaj, KPK-ja, përfundimisht, dënon keqpërdorimin e fjalës së lirë nga ana e Kryeministrit Kurti, duke potencuar se sistemi prokurorial nuk do të ndikohet këto deklarata që vijnë nga qarqet e larta politike, por si institucion i pavarur dhe i paanshëm në ushtrimin e mandatit të vet do t'i shkojë deri në fund çdo rasti që është në dëm të qytetarëve të Kosovës.

Trajtohet analiza për numrin e nevojshëm të prokurorëve në sistemin prokurorial

Prishtinë, 26 dhjetor 2023

Kryetari i Komisionit për Administrimin e Prokurorëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Veton Shabani, ka mbajtur një takim pune me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, z.Sami Istrefi dhe Drejtoreshën e NJSHP-së, znj.Arta Kelmendi, si dhe zyrtarë të njësisve administrative të SKPK-së dhe NJSHP-së.



Qëllimi i këtij takimi ishte trajtimi i Analizës së Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë lidhur me numrin e nevojshëm të prokurorëve në sistemin prokurorial.

Me këtë rast, Kryetari i Komisionit, z.Shabani, ka kërkuar nga NJSHP-ja që në një afat sa më optimal të bëjë plotësimin e kësaj analize dhe sa më parë që të jetë e mundshme të dërgohet për shqyrtim nga ana e anëtarëve të këtij Komisioni, në mënyrë që të hapet rruga për shpalljen e konkursit për rekrutimin e prokurorëve të rinj.

Fjalimi i Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Jetish Maloku, për veprimtarinë njëvjeçare në konferencën e fundvitit për media

Prishtinë, 29 dhjetor 2023

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Të nderuar anëtarë të Këshillit Prokurorial,

Të nderuar të pranishëm,

Mirë se keni ardhur në konferencën e fundvitit, në të cilën do të prezantoj veprimtarinë njëvjeçare të Këshillit Prokurorial të Kosovës, rezultatet dhe sfidat, me të cilat jemi ballafaquar në realizim të mandatit të Këshillit! Më lejoni që të përmend disa nga sukseset dhe punët kryesore të realizuara nga Këshilli, bazuar në mandatin e tij kushtetues dhe ligjor:



Këshilli, këtë vit, ka mbajtur 14 takime dhe ka nxjerrë mbi 190 vendime, të cilat kanë shërbyer për realizimin e mandatit kushtetues dhe ligjor në shërbim të sistemit prokurorial. Për më tepër, Këshilli ka realizuar edhe takime të tjera të shumta përmes komisioneve të veta të përhershme, ad hoc dhe trupave të tjerë, si dhe hartoi dhe miratoi gjashtë rregullore, të cilat kanë të bëjnë me: Komisionin Këshilldhënës për etikën e prokurorëve, veprimtarinë dhe organizimin e brendshëm të administratës së KPK-së, shtesat dhe kompensimet për të punësuarit në sistemin prokurorial, plotësimndryshimin e Rregullores për përzgjedhjen e kryeprokurorëve, për qasje në dokumente publike të sistemit prokurorial dhe organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit.

KPK-ja, pas procedurave të intervistimit dhe vlerësimit, ka emëruar Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale, Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, si dhe ka zhvilluar të gjitha procedurat dhe ka përzgjedhur Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së dhe Drejtorin e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.

Sa i përket rekrutimit të prokurorëve të shtetit, Këshilli ka finalizuar listën me 21 kandidatët më të suksesshëm për prokurorë, të cilët janë dekretuar nga Presidentja dhe kanë filluar trajnimin fillestar në Akademinë e Drejtësisë dhe, bazuar në Ligjin e ri për Prokurorin e Shtetit, të njëjtit kanë filluar të ngarkohen edhe me lëndë me një normë të caktuar.

KPK-ja, përmes rrugëve ligjore, ka avancuar 22 prokurorë dhe transferuar tre të tjerë nëpër prokuroritë e Kosovës, ndërsa në proces e sipër janë edhe dy procese për avancim, kurse lidhur me disiplinimin e prokurorëve, një prej objektivave të Këshillit për këtë vit ka qenë llogaridhënia, profesionalizmi dhe disiplinimi i prokurorëve, me ç'rast, gjatë vitit 2023, KPK-ja ka pranuar nëntë kërkesa për fillim të procedurave disiplinore ndaj prokurorëve dhe ka themeluar nëntë panele hetimore, si dhe deri më tani, përmes paneleve hetimore ka zhvilluar procedura disiplinore dhe ka shqiptuar masa adekuate disiplinore ndaj prokurorëve konform Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të gjitha vendimet e formës përfundimtare janë publikuar në uebportalin e sistemit prokurorial të Kosovës, përveç vërejtjes jopublike me shkrim, siç parashihet me ligj. Përmes Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, Këshilli ka finalizuar vlerësimin e performancës për 56 prokurorë.

Nga ana tjetër, Grupi Monitorues për Mbikëqyrjen e Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, gjatë këtij viti, ka realizuar vizita nëpër të gjitha prokuroritë e Kosovës, si dhe ka hartuar raporte me rekomandime bazuar në të gjeturat, të cilat janë trajtuar në takimet e Këshillit. Si rezultat i kësaj, sistemi prokurorial ka arritur që gjatë periudhës nëntë mujore të këtij viti, nga 468 raste të korrupsionit të pranuar, ka zgjidhur 335 raste, respektivisht, ka zgjidhur 72% të rasteve të pranuar, kurse sa u përket krimeve ekonomike, nga 290 raste të pranuar janë zgjidhur 230 raste, respektivisht janë zgjidhur rreth 79% e rasteve të pranuar. Pra, raportet aktuale tregojnë për një efikasitet në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

Rrjedhimisht, buxheti i Këshillit për vitin 2023 pas rishikimeve buxhetore është 14,801,547,45 euro dhe

deri më tani, KPK-ja ka realizuar 88.7% të buxhetit total, për të gjitha kategoritë ekonomike dhe programet buxhetore të Këshillit për shpenzimet e krijuara deri më 27 dhjetor 2023 (nuk janë të përfshira pagat e muajit dhjetor). Buxheti i Këshillit, sipas Qarkores së Dytë Buxhetore për vitin 2024, është 17,265,867.00€, por as për këtë vit nuk është miratuar plotësisht sipas kërkesave dhe nevojave të sistemit prokurorial. KPK-ja ka pranuar edhe Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, sipas të cilit nuk ka pasur asnjë të gjetur të kualifikuar.



Këshilli ka vazhduar politikën e bashkëpunimit të hapur dhe profesional me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me donatorë dhe partnerë të shumtë, të cilët dua t'i falënderoj edhe përmes kësaj konference për mbështetjen e madhe dhe të vazhdueshme që kanë dhënë dhe po japin për Këshillin Prokurorial.

Sa i përket transparencës publike, KPK-ja ka filluar transmetimin e drejtpërdrejtë të takimeve të Këshillit dhe me përkrahjen e Ambasadës Amerikane ka hapur kanalet zyrtare në Facebook dhe YouTube dhe sistemi prokurorial ka vazhduar publikimin e Raportit 24-orësh, përmes të cilit publiku njoftohet lidhur me veprimet e prokurorive për 24 orë, si dhe kemi caktuar edhe Zyrtarin e ri për Qasje në Dokumente Publike dhe tërë sistemin prokurorial janë të caktuar zyrtarët për sinjalizim. Uebportali i sistemit prokurorial është pasuruar në baza ditore me informata të reja që mund t'u shërbejnë qytetarëve dhe, me përkrahjen e UNDP-së, jemi në proces të finalizimit të uebportalit të ri, i cili pritet të funksionalizohet në fillim të vitit 2024. Në këtë drejtim, KPK-ja nuk do të ndalet së punuari që komunikimi publik, transparenca, llogaridhënia, perceptimi dhe besueshmëria të arrijnë vlerësimin e merituar nga opinioni publik.

Këshilli, në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ka koordinuar dhe mbështetur ngritjen e kapaciteteve të prokurorëve dhe stafit dhe në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë dhe partnerë të

tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë janë organizuar programe të ndryshme trajnuese, bazuar në nevojat e sistemit prokurorial.

Sikurse çdo institucion tjetër, edhe KPK-ja ka pasur sfida gjatë vitit 2023, me ç'rast dëshiroj t'i theksoj disa prej tyre, si: Mosplotësimi i përbërjes së Këshillit me dy (2) anëtarë joprokurorë, që me hyrjen në fuqi të Ligjit për Këshillin Prokurorial në prill vitit 2019 nuk është përgjegjësi e Këshillit as përzgjedhja dhe as procedurat teknike të shpalljes së konkursit, buxheti i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha obligimet e krijuara, pengesat në dekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit, ndërmarrja e aktiviteteve të shumta për mbrojtjen e pavarësisë së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit, që ndërlihen me iniciativat për ndryshime ligjore dhe shkarkim të anëtarit jo prokurorë të Këshillit, specializimi i prokurorëve për trajtimin e krimeve karakteristike (korrupsioni, krimi i organizuar, krimi ekonomik dhe krimet kibernetike), mosrespektimi i parimit të transparencës përmes disa publikimeve mediale që ndikojnë drejtpërdrejt në dëmtimin e besimit të publikut në sistemin prokurorial, ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të sistemit prokurorial.

Lidhur me planifikimin e punës së Këshillit për vitin 2024, për më tepër, duke reflektuar në harmoni me ndryshimet ligjore, Këshilli do të vazhdojë punën në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore përkatëse të parapara me këto ndryshime dhe do të zhvillojë procedurat për zgjedhjen e kryeprokurorëve të Prokurorisë së Apelit dhe gjashtë prokurorive themelore të vendit, duke qenë se mandati i tyre skadon në fund të vitit 2024. Në fillim të vitit 2024 pritet të përfundojë Plani Strategjik për komunikim publik 2024-2026, ndërsa në fund të vitit 2024 do të hartohet dhe finalizohet Plani i ri Strategjik i sistemit prokurorial për vitet në vazhdim.

Në përfundim, ju njoftojmë se Këshilli do të publikojë Raportin e Punës për vitin 2023 në fillim të vitit 2024 dhe do ta bëjë të qashtëm në faqen zyrtare dhe në kopje fizike, me ç'rast publiku dhe Ju, përfaqësues të nderuar të mediave, do të informoheni në detaje për aktivitetet tona gjatë vitit që po e lëmë pas, si dhe do të hartohet dhe publikohet edhe Plani i Punës për vitin 2024, në të cilin do të përcaktohen më në detaje planifikimet për të gjitha njësitë për vitin që po vjen.

Me këtë rast, ju falënderoj juve përfaqësues të mediave të respektuara për bashkëpunimin që kishim gjatë këtij viti dhe ju uroj Vitin e Ri 2023, duke shprehur edhe njëherë gatishmërinë e Këshillit dhe përgjithësisht të sistemit prokurorial për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në të ardhmen.

Faleminderit dhe mirupafshim herëve të tjera!

Urimi i Kryesuesit të KPK-së, Jetish Maloku, me rastin e festës së Vitit të Ri

Të nderuar /a,

Në emër të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe në emrin tim personal, me rastin e festës së Vitit të Ri, ju dërgoj urimet më të mira, duke ju dëshiruar të gjithëve që Viti i Ri 2024 të jetë i mbushur me mundësi të reja, begati, prosperitet, dashuri dhe lumturi në familjet tuaja.

Gëzuar 2024-ta!



Jetish Maloku

Kryesues

Këshilli Prokurorial i Kosovës